REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr.3018/5 Prot

Tiranë, më 31 . 8 .2026

Lënda: Njoftim për ekzekutim vullnetar të gjobës administrative.

**SUBJEKTIT "FENIX TEXTIL", NIPT L71324050A**
Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga Zenel Bastari, Nd. 37, H. 2, Zona Kadastrale Nr. 8340, Nr. Pasurie 5/229, Tiranë

**TIRANË**

Në përfundim të procesit të inspektimit të kryer nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, ***ndaj subjektit "Fenix Textil", me Nipt L71324050A, është marrë Vendimi Përfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2026-002571-5, 11.06.2026, me të cilin është vendosur masa administrative gjobë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë)*** lekë.

Pas marrjes dijeni të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, nga ana juaj nuk është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë **Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve të Inspektoratit të Përgjithshëm**, brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për Inspektimin në Punë", i ndryshuar, ekzekutimi i gjobave administrative kryhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjithashtu, në nenin 15 të Ligjit për Kundërvajtjet Administrative parashikohet se:

*"1. Vendimi për kundërvajtjen administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore nëse ligji i posaçëm parashikon të drejtën e subjektit për t'u ankuar në rrugë administrative, por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për ekzekutimin e tij zbatohen dispozitat e kreut V të këtij ligji."*

Nga sa më sipër, ju njoftojmë se **Vendimi Përfundimtar i Inspektimit** Nr.ISHPSHSH-TR-2026-002571-5, datë 11.06.2026, në përputhje me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", është **shndërruar në titull ekzekutiv** dhe duhet të ekzekutohet në mënyrë vullnetare.

Në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 10279/2010, konkretisht në nenin 30, pika 1, parashikohet se:

*"Gjoba dhe shumat që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, i cili përbën titull ekzekutiv."*

Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se pagesa e gjobës duhet të kryhet **brenda 10 (dhjetë) ditëve.** Bashkëlidhur gjeni **faturën për arkëtimin e gjobës**. Pas kryerjes së pagesës, lutemi të dërgoni **mandatin e arkëtimit** në adresën elektronike: **info@sli.gov.al**.

Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afatit ligjor, **Drejtoria Rajonale Tiranë** do të vijojë me ndjekjen e procedurave për **ekzekutimin e detyrueshëm**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KRYEINSPEKTORI**

**Eljo Muçaj**

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. 183 Datë 28.08.2026

BANKËS _____ Llogaria e te Ardhurave

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranoje nga klientë(persona,persona fizikë, persona juridikë), arkëtime për llogari të institucionit tonë,me emërtime,kode,numer indentifikimi dhe shuma si më poshtë

| | |
|---|---|
| Emri Institucionit përfitues | ISHPSHSH<br>Drejtoria Qëndrore Tiranë |
| Kodi Institucionit Përfitues | **1004210** |
| Kodi Degës së Thesarit ku vepron | **3535** |
| Emri i paguesit (persona/persona fizik/person juridik) | Fenix textil |
| Numri indentifikimit të paguesit | L71324050A |

| | PËRSHKRIMI I TË ARDHURAVE | | SHUMA |
|---|---|---|---|
| ID | Emertimi | Kodi llog.Ekonomike | ARKETUAR |
| Detyrimi | | | Leke |
| 1 | NR.ISHPSHSH-TR-2026-002571-5 date 11.06.2026 | 7115499 | 100,000 |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | Njeqind mije leke | | |
| | **TOTALI** | | **100,000** |

**INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**
**DREJTORIA RAJONALE TIRANË**
**Eljo Muçaj**

**Fenix textil**

**Shënim:Për Bankat e Nivelit të Dytë**
**Në zbatim të nenit 30, ligji 10279 datë 25.05.2010"Për kundravajtjet administrative", fatura për arkëtim është e vlefshme për pagesë brenda 10(dhjetë) ditëve nga data e lëshimit të saj.Në të kundërt anullohet.**